



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:068310

Datë: 30.03.2024

Numri i dokumentit: 05528949

KPPP.nr.1820/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit N.T.SH.P “MIGROS COMMERCE” – Fushë Kosovë, ish-Thertorja, Zona Industriale 4, me NRB: 80056044, kundër debitorit “SHPETA COMERC 2”, Vranjevc-Prishtinë, duke vendosur lidhur me propozimin e kreditorit për përbarim, jashtë seancës, me datë 28.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë për të vendosur në çështjen juridike përbarimore në mes të N.T.SH.P “MIGROS COMMERCE”, dhe debitorit “SHPETA COMERC 2”.
- II. Për të vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin CP.nr.133/17, të datës 06.02.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje përbarimore, ndërsa lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale.

Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për

vendosjen e kësaj çështje është kompetente Gjykata Themelore në Prishtinë, për arsyet si në vijim:

Kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përmbarimore është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, pika 1.2 përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2. : të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”*.

Ndërsa, mjetet juridike në procedurë përmbarimore, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/l-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje: LPP) janë të përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: *“Në procedurën përmbarimore, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa”*, ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit ligj, përcaktohen Mjetet e jashtëzakonshme juridike, ku decidivisht përcaktohet se: *“1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbarimore. 2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbarueshëm për përmbarimin me dhunë”*.

Në rastin konkret, lënda e cila është transferuar në këtë gjykatë ka për objekt caktimin dhe zbatimin e përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, ndërsa nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedurë përmbarimore të përcaktuara në nenin 67 dhe 68 të LPP-së, ashtu që në kuptim të dispozitave nga neni 13, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, kjo gjykatë nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje përmbarimore.

Andaj, duke marrë parasysh faktin se objekt në këtë çështje përmbarimore është caktimi dhe zbatimi i përmbarimit nga gjykata si organ përmbarues sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë mjet juridik për të cilin Gjykata Komerciale do të ishte e kompetencës për të vendosur, kjo gjykatë vlerëson se Gjykata Themelore në Prishtinë është gjykatë kompetente për vendosje në këtë çështje përmbarimore, kjo në mbështetje edhe të dispozitave nga neni 5 i LPP-së.

Nga sa u tha më sipër, në kuptim të nenit 24 dhe 25.2 të Ligjit për procedurën kontestimore, lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2024:068310
Datë: 30.03.2024
Numri i dokumentit: 05528949

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1820/23, datë 28.03.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.